- të dy entitetet në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika Serpska, si dhe në rrethin e Brčko në BiH. Shteti edhe më tej është administrativisht i ndarë në dhjetë kantone, ndryshe nga Republika Serpska.

Mbrojtja e mjedisit mundësohet përmes llojeve të ndryshme të mbrojtjes juridike, duke e përfshirë ligjin administrativ, veçanërisht Konventën e Aarhusit dhe Ligjin për mbrojtje të mjedisit jetësor, si dhe të drejtës penale, Ligjit për kundërvajtje dhe ligjit civil. Zbatimi i Konventës së Aarhusit dhe aktet për liri të informacioneve është i detyrueshëm që nga data e ratifikimit.

E drejta për qasje të lirë në informacione lejon që çdo person të ketë qasje në informacione që kontrollohen nga autoritetet publike, në përputhje me interesin publik, duke pasur parasysh që ato përfaqësojnë të mirë publike dhe se qasja e publikut në informacion promovon transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe të këtyre autoriteteve në relacion me Konventën e Aarhusit dhe ligjet për mjedis jetësor, përkatësisht informacione që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor.

Vëmendja më e madhe në rregulloret e mbrojtjes së mjedisit i kushtohet të drejtës për qasje në informacione edhe për shkak se pothuajse të gjitha aktgjykimet e mbledhura të gjykatave në BeH në vitin 2012 (Gjykatat e rrethit në RS, edhe Gjykata e apelit edhe Gjykata themelore në BD BeH) i kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për qasje të lirë në informacione. Është e domosdoshme të diskutohet për përdorimin e mjeteve juridike për qasje në vendime për të informuar autoritetet kompetente.

Më në fund, Konventa e Aarhusit në shtyllën e saj të tretë e parashikon të drejtën për qasje në drejtësi përmes procedurave për kontestimin e veprimeve dhe lëshimeve nga persona privatë dhe organe publike që janë në kundërshtim me dispozitat. Instrumentet ligjore që lidhen me këtë dispozitë janë dhënë në ligjet e procedurës civile të miratuara në BiH, si dhe në Ligjin për marrëdhënie kontraktuale. Është gjithashtu me rëndësi të theksohet se Ligji për procedurën civile i Republikës Serpska në amendamentet e veta nga 2013 e përfshiu idenë e një padie për mbrojtje të interesit të përbashkët / publik. Kështu shoqatat, organet, institucionet apo organizatat tjera të krijuara në përputhje me ligjin që e mbrojnë kolektivin e parashikuar me ligj të interesave dhe të drejtave të qytetarëve, si pjesë e regjistrit të tyre të veprimtarive të përcaktuara me ligj, mund, kur organi përcakton në mënyrë të qartë me ligj të veçantë dhe në kushte të përcaktuara me atë ligj, të paraqesë padi për mbrojtje të interesit dhe të drejtave të përbashkëta/publike ndaj një personi privat ose personi juridik i cili, me një veprimtari të caktuar dhe punë në përgjithësi, me veprim ose lëshim, i shkel seriozisht ose i rrezikon interesat dhe të drejtat e tilla të përbashkëta.



## 11.4 Shqipëria

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe një numër ligjesh rregullojnë çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor. Nga nënshkrimi i Konventës nga Shqipëria në vitin 1998 deri në ratifikimin e tij në vitin 2001, janë ndërmarrë shumë masa për intensifikim të zbatimit të kërkesave të parashikuara.

Individë, grupe dhe OJQ kanë të drejtë që drejtpërdrejt të parashirojnë ankesë në Gjykatë vetëm nëse kjo parashikohet me ligj.

Nuk ka ndonjë ndryshim thelbësor midis kushteve për pozicionin juridik të individëve dhe organizatave joqeveritare. Publiku ka të drejtë që në procedurë administrative të kundërshtojë ligjshmërinë thelbësore dhe procedurale të vendimeve. Në legjislacionin kombëtar nuk ka asnjë veprim të garantuar *actio popularis*.

Organet për shqyrtim, në procedurë administrative, mund të ndërmarrin këto veprime: a) konfirmimin e vlefshmërisë së aktit dhe refuzim të ankesës; b) revokim të e aktit dhe aprovim të ankimimit; c) ndryshim të aktit administrativ.

Ekzistojnë një numër mangësish në legjislacionin shqiptar që tërthorazi ndikojnë në parandalimin e publikut për të vepruar mbi to. Këto përfshijnë:

- Mungesa e informacionit të duhur për publikun (individë dhe organizata joqeveritare) në lidhje me të drejtën për të apeluar vendime ekologjike dhe njohuri të kufizuara popullore të të drejtave;
- Mungesa e ndihmës juridike falas të ofruar nga shteti (përveç në çështjet penale);
- Mungesa e avokatëve për përfaqësimin e çështjeve me interes publik;
- Mungesa e moduleve të trajnimit ekologjik për studentë / avokatë të rinj.

Nga pikëpamja juridike, mjetet juridike në rastet kundërshtimit të vendimeve/akteve sfiduese në gjykatë dhe organe të tjera janë të përshtatshme. Pengesat kryesore me të cilat kufizohet zbatimi i ndalesave gjyqësore për çështje të mjedisit jetësor, janë e drejtë në diskrecion të gjyqtarëve, të cilët nuk kanë njohuri adekuate të ligjit për mjedisin jetësor, ka mungesë të pavarësisë gjyqësore, zbatimi i papërshtatshëm i ndalimeve gjyqësore dhe të ngjashme.

Sa i përket kostove financiare që ndërlidhen me ndonjë ankesë administrative (në lidhje me rastet e përfshira në nenin 9 paragrafët 1, 2 dhe 3), legjislacioni shqiptar nuk parashikonfare shpenzime në lidhje me ankimimin administrativ për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Përfaqësimi ligjor në procedurën e apelit administrativ nuk është i detyrueshëm. Kostot tipike jo-administrative dhe jashtë gjykatave (jashtë çdo procedure) për çështjet ekologjike në përgatitje për një procedurë më të mirë të apelit administrativ janë: përfaqësuesi, ekspertiza shkencore dhe kostot për mbledhje të provave.

Sa i përket tarifave gjyqësore dhe kostove të tjera që ndërlidhen me shqyrtimin e çështjes në procedurë gjyqësore, shuma nuk varet nga ajo nëse paditësi është person fizik, grup individësh, organizatë joqeveritare ose një entitet tjetër, nuk varet nga lloji i çështjes apo lloji i gjykatës procedurat. Kjo gjë varet nga e ashtuquajtura vlerë e çështjes.

Shpenzimet gjyqësore në lidhje me ekzekutimin e provave të ndryshme, pjesëmarrja e ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë shqyrtimit i bashkëngjiten palës që ka kërkuar prova, përfshirje të ekspertëve ose dëshmitarë.

Në Shqipëri nuk ka ndihmë juridike falas. Nuk ka mundësi për individë/OJQ të pranojnë NJF për çështje nga mjedisi jetësor. OJQ-të ekologjike nuk marrin fonde buxhetore për t'i përdorur ato në procedura gjyqësore.

Pengesat kryesore për qasje në drejtësi në fushën e mjedisit jetësor në Shqipëri përfshijnë:

- shpenzime të larta gjyqësore;
- tarifa të larta kompensimi për paditësit;

- mungesë fondesh për të mbuluar shpenzimet për avokatët dhe ekspertët;
- mungesë e ndihmës juridike falas të ofruar nga shteti (përveç në çështjet penale);
- mungesë e vetëdijes dhe njohjes së Konventës së Aarhusit midis gjyqësorit;
- mungesë e avokatëve që do të përfaqësojnë interesin publik;
- mungesë e sanksionit në legjislacion në rastet kur informacionet nuk jepen;
- mungesë e procedurave të qarta ligjore (hapat ligjorë që duhet të ndiqen dhe institucionet që duhet të zgjidhen) në rast të padive administrative;
- mungesë stafit/punonjësve të kualifikuar në institucionet qeveritare në fushën e mjedisit jetësor;
- mungesë e afatit të vlefshmërisë së lejeve ekologjike.

### 11.5 Konventa e Aarhusit në rajon

Republika e Maqedonisë e Veriut, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia e kanë ratifikuar Konventën e Aarhusit. Autoritetet shtetërore nuk e zbatojnë atë drejtpërdrejt, por pjesërisht për shkak të nevojës për të harmonizuar legjislacionin kombëtar për zbatim (Shqipëria, Mali i Zi), pjesërisht për arsye praktike, por edhe për shkak të interpretimeve të dyshimta të dispozitave kushtetuese për zbatim të drejtpërdrejtë në konventat ndërkombëtare. Në BiH dhe RMV, e drejta ndërkombëtare konsiderohet si ka prioritet se ajo vendore, prandaj edhe autoritetet publike janë në gjendje ta zbatojnë direkt Konventën. Megjithatë, në praktikë nuk ka shumë shembuj se kjo ka ndodhur. Në Serbi, normat ndërkombëtare janë gjithashtu një pjesë integrale e sistemit juridik të brendshëm dhe si të tilla janë direkt të zbatueshme.

### 11.6 Zhvillimi i politikave dhe legjislacionit në Maqedoni

Normat kombëtare duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale. Mekanizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë ofrojnë mbrojtje ligjore kur të gjitha mjetet juridike / mundësitë kombëtare janë shterur.

Republika e Maqedonisë së Veriut, si shtet anëtar i KB dhe Këshillit të Evropës, i ka ratifikuar dokumentet ndërkombëtare dhe ato, në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës, janë pjesë integrale e sistemit juridik të brendshëm. Me ratifikimin, shteti merr përsipër të respektojë, mbrojë dhe garantojë të drejtat e njeriut të inkuorporuara në legjislacionin vendor.

Respektimi i ligjit do të thotë që shteti duhet të përmbahet nga ndërhyrja në gëzimin e të drejtave. Të mbrohet e drejta do të thotë që shteti miraton dhe zbaton ligje që krijojnë mekanizma, institucione dhe procedura me të cilat parandalohet shkelja e të drejtave nga autoritetet shtetërore ose entitetet e tjera. Kjo mbrojtje duhet të sigurohet në mënyrë të barabartë për të gjithë. Për të garantuar të drejtën do të thotë që shteti duhet të ndërmerr masa aktive dhe të sigurojë burime (koordinim, promovim dhe sigurim të të gjitha kushteve për përmbushje) për t'iu mundësuar njerëzve të gëzojnë të drejtat e tyre.

Për të siguruar praktikën më të mira nga fqinjësia dhe rajoni, këtu do të analizohen vetëm mekanizmat ndërkombëtarë në dispozicion të qytetarëve të RSM, e jo ato kombëtare.

### 11.7 Mekanizmi i Aarhusit për apel

Duhet përmendur edhe mundësia për parashtrim të ankesave në bazë të Konventës së Aarhusit. Mekanizmi i Konventës së Aarhusit është një nga disa instrumentet ndërkombëtare për mbrojtje të mjedisit jetësor që u lejon anëtarëve të publikut të shprehin shqetësimet e tyre drejtpërdrejt në një panel të pavarur ekspertësh. Komiteti për ankesa (Complaint Committee) ka mandat të hetojë pretendimet në këtë rast, mund të bëjë rekomandime ose të përmbushë nënshkruesit direkt palës në fjalë.

Komiteti gjithashtu mund të shqyrtojë çështjet për harmonizim me iniciativën e tij dhe të bëjë rekomandime; të përgatisë raporte për harmonizimin ose zbatimin e dispozitave të Konventës; të sigurojë këshilla ose ta lehtësojë ndihmën e individit.

*Deri në këtë moment, para Komitetit nuk ka raste nga vendi jonë.*

### **11.8 Konventa për mbrojtjen botës së egër bimore dhe shtazore dhe habitatet natyrore në Evropë (Konventa e Bernës)**

Një mekanizëm tjetër ndërkombëtar që përdoret në Republikën e Maqedonisë së Veriut është Konventa për mbrojtjen e botës së egër bimore dhe shtazore dhe habitatet e tyre natyrore në Evropë, e ratifikuar në vitin 1997. Rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*) është përfshirë në Shtojcën 2 të Konventës së Bernës, e cila është një njohje e madhe dhe një hap përpara në mbrojtjen e kësaj kafshe të rrezikuar kritike që është e pranishme vetëm në Ballkan.

Në vitin 2013, një ekspert i pavarur në Mekanizmin për ankesa në Bankën evropiane për rindërtim dhe zhvillim (BERZH), e cila e mbështet financiarisht projektin, publikoi gjetjet që konfirmojnë se studimi mjedisor për Boshkov Most nuk është i plotë, sepse i mungojnë të dhëna të rëndësishme. Eksperti konfirmoi se gjatë miratimit të vendimit për mbështetje financiare të projektit, banka i kishte shkelur procedurat e saja ekologjike Komiteti i përhershëm i Konventës së Bernës për mbrojtje të botës së egër bimore dhe kafshëve dhe habitatet natyrore në Evropë i ka kërkuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut të ndërpresë urgjentisht ndërtimin e hidrocentraleve të vogla në Parkun Kombëtar Mavrovë, kanë publikuar organizatat e shoqërisë civile ekologjike nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Në të njëjtën kohë, ekziston një iniciativë për pezullimin e HEC e Ribnicës, Jadovës dhe Zhirovnicës I dhe II, për të cilat koncesionet janë miratuar në 2015, dhe ndërtimi i të cilave nuk ka filluar ende. Deri më tani, në territorin e PK Mavrovë nga viti 2010 deri në vitin 2017, janë ndërtuar katër hidrocentrale të rinj të vegjël në lumenjtë Tresoneçka, i Galiçës, Kakaçit dhe Beliçica.

### **11.9 Mekanizmat rajonalë për mbrojtje gjyqësore që janë në dispozicion të qytetarëve të RMV**

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut është mekanizëm që mund të përdoret nëse të gjitha mjetet juridike në shtetin amë janë shterur dhe nëse shteti e ka ratifikuar Konventën. Vendi ynë e ka ratifikuar Konventën dhe përdorimin e saj kërkohet shkelje konkrete e ndonjë neni të caktuar të saj. Konventa e bën dallimin midis dy llojeve të ankesave: individuale - të paraqitura nga ndonjë person, grup individësh, kompani ose organizatë joqeveritare, e cila parashtron ankesë për shkelje të të drejtave dhe ankesë ndër-shtetërore e parashtruar nga një shtet kundër një shteti tjetër. Që nga themelimi i Gjykatës, pothuajse të gjitha ankesat janë paraqitur nga individë të cilët janë drejtuar me çështjet e tyre drejtpërdrejt në Gjykatë, duke u konsideruar si viktimat e një ose më shumë shkeljeve të Konventës.

Ankesat mund të paraqiten drejtpërdrejt nga individë. Ndiqja e avokatit, në fillim të procedurës, nuk është e domosdoshme. Mjafton në Gjykatë të dërgohet formulari i ankesës i plotësuar saktë, si dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me ankesën. Sidoqoftë, regjistrimi i një anese nga Gjykata nuk garanton se ankesa do të jetë e pranueshme ose se çështja në fjalë do të jetë e bazuar. Sistemi i Konventës siguron qasje „të lehtë“ në Gjykatë, duke i mundësuar secilit individ të parashtrorë ankesë, madje edhe nëse ai/ajo jeton në ndonjë rajon të largët të shtetit anëtar ose nëse ai/ajo nuk ka fare mjete financiare.

Duke marrë në konsideratë atë që u tha më sipër, nuk ka fare shpenzime për procedurë para Gjykatës.

Ankesat duhet të plotësojnë një numër të caktuar kriteresh që ato të mund të shpallen si të pranueshme nga Gjykata. Përndryshe, ankesat nuk do të merren parasysh fare. Ankimuesi duhet të ketë qenë, personalisht dhe drejtpërdrejt, viktimë e shkeljeve të Konventës dhe duhet të ketë pësuar dëme të konsiderueshme. Sigurisht, nuk duhet të harrohet se ankesat mund të parashtrihen vetëm kundër një ose më shumë shteteve anëtare të Konventës, por jo edhe kundër cilitdo shtet ose individ.

Organizatat joqeveritare si dhe shtetet kanë të drejtën të parashtrojnë ankesa. Veç kësaj, atyre mund të jepet leja nga Kryetari i Gjykatës të ndërhyjnë në procedurë si palë e tretë. Kryetari i Gjykatës mund të lejojë që një person tjetër i ndryshëm nga ankimuesi, si dhe çdo shtet anëtar i Konventës, ndryshe nga ai kundër të cilit është parashtruar ankesa, të ndërhyjë në procedurë. Kjo situatë quhet ndërhyrje e palës tretë. Personi ose shteti në fjalë ka të drejtë të paraqesë parashtrësia dhe të marrë pjesë në seanca publike.

Kur Gjykata të pranon ndonjë ankesë të caktuar, ai mund të vendosë që shteti kundër të cilit është paraqitur ankesa, duhet të ndërmarrë disa masa të përkohshme, derisa ndërkohë Gjykata e shqyrton çështjen. Këto masa zakonisht konsistojnë në kërkesë deri te shteti që të përmbahet nga realizimi i veprimeve të caktuara.

Disa ankesa mund të cilësohen si urgjente dhe zgjidhja e tyre është prioritet. Këto situata janë në rastet kur ka pretendime nga ankimuesi se ai/ajo po përballet me një rrezik të drejtpërdrejt të lëndimit fizik.

Në lidhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të drejtave të njeriut (GJEDNJ), ku ekziston një lidhje midis mbrojtjes së mjedisit me të drejtën e jetës dhe të drejtave të tjera siç janë e drejta e mbrojtjes së jetës private dhe familjare, e drejta për ilaç juridik efektiv, raste që janë interesante janë:

- L'Erabliere A.S.B.L. v.s. Belgium. Procedura e një organizate joqeveritare për mjedis jetësor me të cilën kundërshtohet leja për planifikimit urban, e refuzuar sepse nuk janë përshkruar faktet e çështjes, por gjykata i ka ditur faktet nga një procedurë gjyqësore e mëparshme.
- Locascia dhe të tjerët v. Italia (nr. 35648/10) e iniciuar nga 19 aplikantë, të cilët jetojnë në komunat Caserta dhe San Nicola La Strada në bazë të nenit 2 dhe nenit 8 të Konventës, janë ankuar për rrezikun mbi shëndetin e tyre dhe për pengimin e shijimit të jetës private dhe shtëpisë për shkak të aktiviteteve të fabrikës LO Utaro dhe dështimit të autoriteteve për të siguruar pastrim pas mbylljes së fabrikës. Ky rast edhe vazhdon.
- Cordella dhe të tjerët v. Italia (nr. 54414/13) (52 aplikues) dhe Ambrogi Melle and others v. Italy (nr. 54264/15) (130 aplikues). Këta aplikues, të cilët jetojnë afër Tarantos, pretendojnë se autoritetet nuk ia kanë dalë të ndërmarrin masat e duhura për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e individëve, dhe po kërkojnë të shkelin nenet 2, 8 dhe 13 të Konventës. Ky rast po vazhdon.

## 12. PRAKTIKA GJYQËSORE NË EVROPË ME FOKUS NË MJEDISIN JETËSOR DHE NDIHMËN JURIDIKE FALAS

### 12.1 Zhvillimi i praktikës gjyqësore

Sipas KB, nëse një shtet i shkel të drejtat e qytetarëve të tij, ata mund individualisht ose kolektivisht të paraqesin ankesa për shkelje të të drejtave të tyre të mbrojtura nga protokollet fakultative të disa prej konventave: Komiteti për të drejtat e njeriut i garantuar nga Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike; Komitetit për eliminim të të gjitha formave të diskriminimit racial; Komiteti për eliminim të diskriminimit ndaj grave për të drejtat e garantuara me konventën për ndalimin të të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave; Komiteti kundër torturës për të drejtat e garantuara me Konventën kundër torturës; Komisioni për të drejtat e fëmijëve për të drejtat e garantuara me Konventën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; te Komiteti për të drejtat e personave me pengesa në përputhje me Konventën për të drejtat e personave me pengesa dhe të ngjashme. Në kuadër të Konventës së Aarhus është Komiteti Koordinues ose i ashtuquajtur Komiteti i Aarhusit për ankesa. Këto procedura mund t'i shqyrtojmë si mekanizma jashtë gjykatës. Nga ana tjetër, ekzistojnë dy mekanizma kryesorë gjyqësorë rajonalë që garantojnë qasje në drejtësi për qytetarët e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare të Këshillit të Evropës.

### 12.2 Gjykata Evropiane e drejtësisë

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian<sup>17</sup> (Gjykata) është kompetente të monitorojë nëse ligji i BE interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të barabartë në secilin prej shteteve anëtare. Me fjalë të tjera, nëse ligjet e BE-së janë identike për të gjitha palët dhe në të gjitha rrethanat. Për këtë qëllim, Gjykata shqyrton anën juridike të procedurave të institucioneve të BE-së, kontrollon nëse shtetet anëtare janë duke i përmbushur detyrimet e tyre dhe e interpreton ligjin e BE-së me kërkesë të gjykatave kombëtare.

Gjykata ka autorizime për të zgjidhur mosmarrëveshjet ligjore midis vendeve anëtare, institucioneve të BE-së, bizneseve dhe individëve. Për të trajtuar mijëra çështjet që i pranon, Gjykata është e ndarë në dy organe kryesore: Gjykata për të drejtat, e cila merret me pretendime për gjykime paraprake të marra nga gjykatat kombëtare, akte të caktuara për anulim dhe ankesa dhe Gjykata e përgjithshme, e cila rregullon të gjitha veprimet për anulimin e iniciuar nga individë dhe kompani, si dhe disa procedura të ngjashme të nisura nga shtetet anëtare. Tribunali i administratës publike, e cila është gjykatë e veçantë, gjykon në mosmarrëveshje midis BE –së dhe zyrtarëve të saj.

### 12.3 Gjykata e drejtësisë dhe implementimi i Konventës së Aarhusit DERI KËTU

Analizat e deritanishme tregojnë se edhe në nivel evropian, qasja në drejtësi në çështjet ekologjike përmban disa mangësi të mëdha, veçanërisht në nivelin e gjykatave kombëtare<sup>18</sup> të cilat nuk janë gjithmonë në gjendje të mbështesin sistem të mbrojtjes gjyqësore që është i pranishëm në nivel të BE-së për aktivitete të drejtpërdrejta ekologjike.

Të ballafaquar me qasjen tejet konservatore të gjykatave të BE-së ndaj kërkesave për pranim, një zgjidhje e propozuar nga disa studiues evropian do të ishte amendamenti në nenin 263 (4) i marrëveshjes për BE për të mundësuar qasje më të mirë në drejtësi në çështje lidhur me mjedisin jetësor në nivel të BE.<sup>19</sup> Në fakt, me miratimin e Konventës së Aarhusit legjislativi i BE-së në

17 Burimi: Përshkrimi i Bashkimit Evropian – “Si funksionon Bashkimi Evropian”, Komisioni Evropian, 2012

18 sipas nenit 216 të Marrëveshjes së BE-së, gjykatat e BE-së janë të detyruara nga marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga BE.

19 Research Articles: Access to Justice in Environmental Cases after the Rulings of the Court of Justice of 13, January 2015: Kafka Revisited?, **Hendrik Schoukens** <https://www.utrechtjournal.org/articles/10.5334/ujiel.di/>

njëfarë mënyre anashkalon procedurën e vështirë të ndryshimit të neneve nga Marrëveshja për BE-në, vetëm për të siguruar qasje më të gjerë në drejtësi në çështjet e mjedisit jetësor.

Duke refuzuar të përdorë Konventën e Aarhusit si një kriter referencë për rishikimin e ligjshmërisë së rregullativës së Aarhusit, GJDBE i ka shuar pritshmëritë e atyre që besonin se gjyqtarët e BE-së përfundimisht do të jenë të përgatitur të braktisin, sipas publikut të ekspertëve, qasjen e vjetruar të Plaumanit ndaj çështjeve të mjedisit jetësor.

Sipas publikut të ekspertëve, GJDBE ka vendosur të injorojë nenin 9 (3)<sup>20</sup> të Konventës së Aarhusit, pavarësisht referimit të qartë të dispozitës së fundit në Rregulloren e Aarhusit. Rezultati indirekt i kësaj është se e ka kufizuar rëndësinë e Rregullores së Aarhusit në vendime që janë në gjendje të ndikojnë në interesat e atyre që i pranojnë ato vendime, duke e përjashtuar kështu auditimin administrativ të shumicës së akteve të BE-së në fushën e mjedisit jetësor.

Kritikët e ashpër argumentojnë se vendimet e GJDBE duhet të kualifikohen si një hap i rëndësishëm prapa për mbrojtjen gjyqësore në çështjet mjedisore të lidhura me BE-në.

## 12.4 Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut

Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut është themeluar në vitin 1959 dhe i rregullon kërkesat individuale ose shtetërore për pretendime për shkelje të të drejtave civile dhe politike të përcaktuara në Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut. Nga viti 1998 kjo gjykatë punon me kohë të plotë ashtu që edhe individë mund të drejtohen direkt. Në gati pesëdhjetë vjet, Gjykata ka sjellë më shumë se 10,000 aktgjykime. Ata janë obligative për palët e interesuar dhe të përfshira dhe i kanë detyruar qeveritë të ndryshojnë legjisllacionin e tyre dhe praktikën administrative. Praktika e Gjykatës e bën Konventën një instrument të fuqishëm për të përmbushur sfidat e reja dhe forcimin e sundimit të ligjit dhe demokracisë në Evropë.

Si të parashtrohet një aplikacion në Gjykatën Evropiane të të drejtave të njeriut<sup>21</sup>.

Gjuhët zyrtare të Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut janë anglishtja dhe frëngjishtja, por pala mund të aplikojë me shkrim në Sekretariat në gjuhën zyrtare të një prej shteteve që e kanë ratifikuar Konventën. Për të filluar procedura është e nevojshme që të plotësohet Formular për ankesë, krejtësisht, dhe të nënshkruhet nga ankimesi dhe përfaqësuesi i tij/saj. Nëse ankesa parashtrohet me postë elektronike ose faks, formulari i ankesës i plotësuar në letër duhet të dërgohet me postë. Por së pari, është e rëndësishme të shteren të gjitha mjetet ligjore vendore. Më poshtë janë paraqitur disa çështje relevante nga Gjykata.

## 12.5 Komiteti për harmonizim me Konventën e Aarhusit

E drejta e qasjes në drejtësi është një term që e përshkruan shtyllën e tretë të Konventës së Aarhusit dhe përfshin edhe të drejtën e një mjeti juridik. Në lidhje me shtyllën e tretë të KA, kjo e drejtë ka të bëjë me një rishikim të mundshëm të vendimeve të marra nga organet relevante të shkallës së dytë, përmes përdorimit të mjeteve juridike në lidhje me dy shtyllat e para të Konventës së Aarhusit - e drejta për qasje në informacione dhe e drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrje. Kjo është gjithashtu e rëndësishme kur bëhet fjalë për procedurat për shqyrtim të veprave dhe lëshimeve nga persona privatë dhe autoritete publike në kundërshtim me dispozitat e legjisllacionit të tyre kombëtar për mjedisin jetësor. E drejta për qasje para drejtësisë nënkupton të drejtën për qasje te te mjetet juridike, në dispozicion para gjykatës ose ndonjë organ tjetër të pavarur dhe të paanshëm të themeluar me ligj.

<sup>20</sup> Neni 9, paragrafi 3, i Konventës së Aarhusit

<sup>23</sup> Secila palë do të sigurojë që subjektet publike (të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin kombëtar, nëse ka) të kenë qasje në procedurat administrative ose gjyqësore për veprime dhe mosveprime sfiduese nga persona fizikë dhe autoritete publike të vendosura atje në kundërshtim me dispozitat e ligjit kombëtar të asaj pale kontraktuese në lidhje me mjedisin jetësor.

<sup>21</sup> [https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook\\_access\\_justice\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_access_justice_ENG.pdf)



Në vitin 2002, në mbledhjen e parë të vendeve nënshkruese në Luka, Itali, u mor një Vendim me të cilin u themelua një mekanizëm për zbatimin e dispozitave të Konventës - Mekanizmit Ankesave të Aarhusi. Ky organi është definuar si „natyrë jo konfrontuese, jo gjyqësore dhe këshilluese, për të konsideruar pajtueshmërinë e dispozitave të kësaj Konvente“. Kjo sugjeron që qëllimi i saj nuk është të zgjidhë mosmarrëveshje kundër shteteve të caktuara, por të ndihmojë në identifikimin e mangësive në transponimin dhe zbatimin e Konventës dhe të japë rekomandime për anulimin e tyre.

Konventa ka një mekanizëm unik për verifikimin e pajtueshmërisë, i cili mund të aktivizohet në katër mënyra:

1. Pala (shteti nënshkrues i Konventës) paraqet një kërkesë për pajtueshmërinë e vet me Konventën;
2. Pala (shteti nënshkrues i Konventës) paraqet një kërkesë për pajtueshmërinë e palës tjetër (vendi nënshkrues i Konventës);
3. Sekretariati i Konventës i referohet Komitetit, përkatësisht paraqet një referat; ose
4. Një anëtar i publikut mund të paraqesë një komunikim kundër shtetit nënshkrues të Konventës

Komiteti i Ankesave të Aarhusit ka 3 funksione kryesore:

1. të rishikojë të gjitha ankesat, referatet ose komunikimet;
2. me kërkesë të Takimit të palëve për të përgatitur një raport mbi transponimin dhe zbatimin e Konventës në disa vende nënshkruese;
3. të monitorojë, vlerësojë dhe mundësojë transponimin dhe zbatimin e Konventës në vendet nënshkruese.

Forca ligjore e Komitetit të Apelit të Aarhusit qëndron në atë që pas raportit dhe rekomandimeve të Komitetit, Takimi i palëve mund të marrë masa të përshtatshme për të arritur pajtueshmërinë e plotë.

Një nga mënyrat me të cilat mund të fillohet një procedurë përpara Komitetit të Ankesave në Aarhusit është parashtrimi i një komunikimi (ankese) nga publiku. Ky opsion ligjor është në dispozicion për çdo person fizik ose juridik, përfshirë organizatat e shoqërisë civile.

Publiku mund të komunikojë në më tepër baza:

- Mangësi e përgjithshme institucionale - një shtet nënshkrues nuk i ndërmerr masat e nevojshme legislative, rregullatore ose masa të tjera të nevojshme për zbatimin e Konventës në përputhje me nenin 3 paragrafi 1;
- Mos përmbushja e objektivave specifike të Konventës - një shtet nënshkrues ndërmerr masa të caktuara legislative, rregullatore ose masa të tjera për të zbatuar Konventën të cilat nuk i arrijnë objektivat e saj; dhe
- Shkelje konkrete e një të drejte ose detyrimi sipas Konventës - një shtet nënshkrues ndërmerr një veprim të caktuar me të cilin shkelet ndonjë dispozitë konkrete.

## 12.6 UNECE – Komisioni i KB për Evropë

Shqetësimi i UNECE për çështjet e mjedisit jetësor daton që nga viti 1971, kur u formua një grup këshilltarësh të lartë të qeverive të UNECE për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, që rezultoi me formimin e Komiteti për Politika për mjedisin jetësor, i cili tani mblidhet një herë në vit.

Qëllimi i tij kryesor është të vlerësojë përprjekjet e vendeve për të ulur ngarkesën nga ndotja dhe menaxhimin me burimet natyrore, të integrohen politikat ekologjike dhe socio-ekonomike, t'i harmonizojnë kushtet dhe politikat e mjedisi jetësor në rajon dhe të nxisin përfshirjen e publikut në lidhje me mjedisin jetësor dhe në vendimmarrje.

Komiteti është organi i përgjithshëm drejtues i aktiviteteve mjedisore të UNECE.

Puna e Komitetit bazohet në disa shtylla strategjike:

- Sigurimi i një sekretariati për procesin “Mjedisi jetësor për Evropën” dhe pjesëmarrje në promovimin rajonal të Agjendës 21;
- Zhvillimi dhe zbatim të Udhëzimeve të UNECE për vlerësim të mjedisit jetësor në vendet e UNECE që nuk janë anëtare të OECD; DERI KËTU
- Mbikëqyrje të aktiviteteve të UNECE për monitorim, vlerësim dhe raportim për mjedisin jetësor;
- Rritja e efektivitetit të përgjithshëm të marrëveshjeve shumëpalëshe për mjedis jetësor të UNECE dhe lehtësimi i shkëmbimit të përvojave për zbatimin e marrëveshjeve shumëpalëshe për mjedis jetësor: Konventa GJEDNJ, Konventa e Aarhusit, Konventa për ndotjen ndërkufitare të ajrit, Konventa për mbrojtje dhe përdorim të rrjedhave të ujërave ndërkufitare dhe liqenet ndërkombëtare dhe Konventa për pasojat ndërkufitare nga aksidentet industriale.
- Pjesëmarrja dhe/ose lehtësimi i shkëmbimit të përvojave në një numër aktivitetsesh ndërsektoriale të ndërmarrja nën udhëheqje të UNECE (për shembull, arsim për zhvillim të qëndrueshëm, transport, shëndeti dhe mjedisi jetësor, ndërtimet e gjelbra) ose në partneritet me organizata të tjera (p.sh. nisma për siguri, proces evropian për mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit).

## 13. Praktika gjyqësore në gjykatat kombëtare në vende të ndryshme në botë dhe Evropë

### 13.1 Praktika gjyqësore në Armeni

#### Çështja Teghout 30 tetor 2009 dhe 1 prill 2011 Rezume numër 1 (30 tetor 2009)

Tre organizata joqeveritare - Qendra kundër korrupsionit e Transparensiu Interneshënëll, Ekoera dhe Zyra e Komitetit të Helsinkit e qytetarëve të Vannadzor - kanë paraqitur një padi përpara Gjykatës Administrative të Armenisë për të kundërshtuar ligjshmërinë e akteve administrative që lejojnë nxjerrjen e bakrit-molibden në rajonin e Teghut. Gjykata Administrative e ka refuzuar ankesën, duke iu referuar neneve 3 dhe 79 të Ligjit për procedurë administrative të Armenisë. Nenet e përmendura kanë parashikuar se personat juridikë dhe fizikë janë konsideruar se kanë qasje në drejtësi nëse veprimet administrative, lëshimet dhe veprimet i shkelin ato ose ato mund të shkelin drejtpërdrejt të drejtat e tyre dhe interesat legjitime. Duke e hedhur poshtë vendimin në Gjykatën e Kasacionit të Armenisë, OJQ-të Transparensi interneshënëll dhe Ekoera kanë kërkuar nga gjykata që të rrëzojnë vendimin sipas nenit 9 të Konventës së Aarhusit, që është pjesë integrale e sistemit juridik të Armenisë sipas nenit 6 të Kushtetutës së Armenisë.

Gjykata e kasacionit ka deklaruar se OJQ Ekoera është një entitet i themeluar në bazë të ligjit armen për OJQ-të dhe i plotëson kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe e promovon mbrojtjen e mjedisit jetësor në bazë të misionit dhe objektivave të përcaktuara në statutin e saj. Kështu, Gjykata konstatoi se OJQ-ja Ekoera kishte të drejtën e hyrjes në drejtësi para gjykatave në lidhje me çështje me mjedisin jetësor. Megjithatë gjykata ka konstatuar OJQ-ja Transparensi Interneshënëll Qendra për anti-korrupsion nuk kishte interes të mjaftueshëm për këtë çështje dhe për këtë arsye nuk ka pas qasje në drejtësi në interes të mbrojtjes publike ekologjike. Në bazë të vendimit e mësipërm, Gjykata Administrative e ka pas për obligim të merrte në konsideratë elementet thelbësore të çështjes.



## Rezime numër 2 (1 prill 2011)

Në një aktgjykim të 24 marsit 2010, Gjykata Administrative e Armenisë e ka riafirmuar qëndrimin e saj mbi gjendjen e OJQ-së Ekoera, sipas së cilës ferrosna fizikë dhe juridikë nuk mund të kërkojnë mbrojtje të «ndonjë ose ndonjë të drejte abstrakte» në gjykatë. Edhe një herë, kërkesa e OJQ-së ekologjike është refuzuar. Të pakënaqur me këtë, OJQ-ja Ekoera përsëri ka apeluar në Gjykatën e Kasacionit të Armenisë. Megjithatë, Gjykata e Kasacionit në vendimin e 1 prillit 2011 ka deklaruar: «... Në vendimin nr. 906, Gjykata Kushtetuese e Armenisë e shqyrtoi kushtetutshmërinë e fjalës së vet për termin shkëlur. Në nenin 3 paragrafi 1 të Kodit Ekonomik të Armenisë ka përcaktuar se dispozita është në përputhje me Kushtetutën e Armenisë. Nga logjika e legjislacionit armen rrjedh se mbrojtja efektive e të drejtave të shkëlura përfshin, ndër të tjera, të drejtën për t'u gjykuar në një gjykatë të ligjit për subjektet, të drejtat e të cilave janë shkëlur drejtpërdrejt. «Në bazë të konkluzionit të Gjykatës Kushtetuese e në lidhje me dispozitat përkatëse të Kodit për procedurë administrative të Armenisë, Kodin e procedurës civile të Armenisë, Gjykata e Kasacionit e ka refuzuar ankesën për kasacion dhe e ka miratuar vendimin e 24 marsit 2010 të Gjykatës Administrative Armene.<sup>22</sup>

### 13.2 Praktika gjyqësore në Belgjikë

#### Lenaerts c.s. v. nv 's Heerenbosch, Nr. 70/2007

##### Konteksti

Akti i 12 janarit 1993 «përcaktimi i së drejtës së veprimi për mbrojtje të mjedisit jetësor» iu lejon organizatave ekologjike që plotësojnë kërkesa të caktuara, të fillojnë procedura për ndërprerjen e veprimeve që qartë janë shkelje e ligjit për mjedis jetësor ose janë kërcënime serioze për kundërvajtje të tilla para Kryetarit të Gjykatës së shkallës parë (Gjykata e qarkut). Ligji e autorizon kryetarin e gjykatës së shkallës parë të përcaktojë dhe, kur është e përshtatshme, të urdhërojë ndërprerjen e sjelljeve të gabuara ose kërcënimeve serioze për kundërvajtje të tilla, ose të urdhërojë masa për të parandaluar dëmtimin e mjedisit jetësor.

Përveç organizatave për mbrojtje të mjedisit jetësor, autoritetet administrative dhe komunale mund të ndërmarrin masa për ta ndaluar atë. Veç kësaj, neni 271 i ligjit të ri komunal lejon një ose më shumë banorë të një komune të veprojnë në emër të komunës nëse kryetari dhe zyrtarët nuk e bëjnë këtë. Shumë shpejt në praktikën gjyqësore u pranua që kjo dispozitë mund të kombinohej me Aktin e 12 janarit 1993, në mënyrë që qytetarë individualë të mund të sillnin një procedurë të tillë në dobi të organit komunal që i plotëson kushtet duke e marrë vendin e komunës që nuk pranon të ndërmarrë një veprim të tillë. Kjo praktikë gjyqësore u aprovua nga Gjykata Supreme (Hof van Cassatie, 14 shkurt 2002, RW 2001-2002, 1504), kur nga leximi i përbashkët i dy Veprimeve të lartpërmendura përcaktoi që nëse kryetari i komunës dhe zyrtarët nuk ndërmarrin veprime në ato rrethana, një ose më shumë banorë mund të ndërmarrin veprime ligjore në emër të komunës për të mbrojtur mjedisin jetësor. Interesi nuk duhet të demonstron procedurë për ndërprerje nuk varet nga gjendja e shpejtësisë apo urgjencës (Hoff van Casati, 5 mars 1998, TMR 1998, 161).

##### Rast

Disa banorë të komunës Ostmal në lidhje me qëndrimin, në emër të asaj komune kanë miratuar një procedurë kundërvajtëse bazuar në lejen e ndërtimit nga e njëjta komunë e cila dyshohet se ishte dhënë në mënyrë të paligjshme. Banori ka ngritur padi pasi këshilli shtetëror (Gjykata Supreme Administrative) e ka refuzuar kërkesën për pezullim të lejes. Kryetari i Gjykatës së shkallës parë në Antwerpen e ka shpallur aktin të papranueshëm, duke deklaruar se neni 271 i aktit të ri komunal nuk mund të zbatohet kur leja ishte lëshuar nga komuna në favor të së cilës banorët kishin ndërmarrë veprime. Pas ankesës, Gjykata e Apelit Antwerpen ka dërguar pyetje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese nëse dispozitat i shkelin nenet 10, 11 dhe 23 të Kushtetutës, nëse interpretohen në atë mënyrë që procedura e ndalesës ishte e përjashtuar kur komuna e ka paraqitur lejen e ndërtimit ose ekologjike.

<sup>22</sup> [http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.j/Jurisprudence\\_prj/ARMENIA/Armenia\\_2009\\_2011\\_Teghout.pdf](http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.j/Jurisprudence_prj/ARMENIA/Armenia_2009_2011_Teghout.pdf)

## Aktgjykimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese ka vendosur që nëse këto rregulla interpretohen në atë mënyrë që e drejta për të «zëvendësuar veprimin» nuk mund të ushtrohet nga qytetarë individualë në rastet kur (nga hipoteza të paligjshme) leja ishte lëshuar nga të njëjtat autoritete vendore për aktivitetin e të kritikuar që e dëmton mjedisin jetësor. Interpretimi i tillë do të bënte dallim në trajtimin e qytetarëve që nuk mund të justifikohet. Interpretimi i tillë shkelte parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit të përfshirë në nenet 10 dhe 11 të Kushtetutës. Vetëm interpretimi që lejon qytetarët të prezantojnë një veprim të tillë është në përputhje me dispozitat e përcaktuara të Kushtetutës. Si rezultat, veprimi duhet të shpallet i pranueshëm.<sup>23</sup>

**VZW Milieufrent Omer Wattez v. Deputatie Provincie Oost-Vlaanderen/  
stad Geraadsbergen – Intervening party: VZW Vlaams Zweefvliegcentrum,  
Nr. 193.593**

Leja ekologjike ishte lëshuar nga qeveria provinciale e Ostt-Vlaannenden për punë të një aeroporti për aeroplanë pa motora në një zonë bujqësore skenike dhe të vlefshme. Vendimi u parashtruar nga VZW Milieufrent, duke pretenduar se shkelte skicat e planifikimit në zonë të tillë. Lidhur me çështjen e pranueshmërisë, Këshilli i shtetit ka deklaruar se sipas akteve nënligjore të tij, «VZW Milieufrent Omer Wattez» është një OJQ ekologjike që është aktive në rajonin Ardenet Flamane, të cilit i takon qyteti Gerardsbergen. Interesi kolektiv për funksionimin e OJQ-ve është mjaft i specializuar dhe i referohet planifikimit të përdorimit të tokës, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe mbrojtjes së natyrës. Ky synim nuk përkon me interesin e përgjithshëm, as me interesat individuale të anëtarëve të tij. Përkundrazi, buron nga leximi i kombinuar i nenit 2, paragrafi 5 dhe nenit 9, paragrafi 2 i Konventës së Aarhusit, i cili sugjeron që OJQ-të ekologjike si ankimues duhet të kenë qasje efektive në drejtësi. Në Konventë, OJQ-të ekologjike duhet të kenë qasje në Këshillin shtetëror. Kështu, vendimi i qeverisë provinciale të 2 shkurtit 2006 për të dhënë një leje të tillë u anulua<sup>24</sup>

